

**AKT THEMELIMI
MARKON SH.P.K**

Sot më datë 02.03.2023 ne palet e me poshtme vendosem:

- Apostol Dhimiter PAPA , i datelindjes 19.04.1972, lindur në Mazhan, Përmet, banues në Tiranë, i identifikuar prej meje nëpërmjet Leternjoftimit ID me nr. Personal H20419061F, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

- Gramoz Safet TODORI, i datelindjes më 27.05.1989, lindur në Kollovoz, Kukës, dhe banues në Tiranë, identifikuar nepermijet Leternjoftimit ID me nr. Personal I90527045F, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar.

- Ylvi Sami DURMISHI, i datelindjes 20.12.1990, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, Identifikuar nepermijet Leternjoftimit ID me nr. Personal J01220066A, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Ne ortaket themelues te shoqerise "MARKON" SHPK, vendosem te nenshkruajme Aktin e Themelimit te shoqerise shoqerise me perjegjesi te kufizuar "MARKON" SHPK me objekt sipas Statutit dhe Aktit te Themelimit dhe me rregullim ligjor sipas legjislacionit ne fuqi.

EMËRTIMI

Emërtimi i Shoqërisë është "MARKON" SH.P.K., me poshtë e quajtur "Shoqëria".

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Registrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

SELIA

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. "Abdi Toptani", ndertesa "Torre Drin" katër i pare, Zyra 18, Tirane.

Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme, përvç selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Registrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

OBJEKTI

Objekti i Shoqërisë do të konsistojë në:

-Krijim dhe mirembajtje l aplikacioneve, serverave, softwareve dhe faqe web.

-Prodhim, shitje dhe menaxhim i sistemeve web dhe aplikacion. Perpunim, insertim, heqje dhe administrim te dhenash. Kryerjen e çfarëdolloj aktiviteti ne fushën e

marketingut online me qëllim promovimin e produkteve dhe shërbimeve te kompanive te ndryshme.

Për këtë qëllim, Shoqëria mund të veprojë si në Shqipëri dhe jashtë vendit. Kompania gjithashtu mund të veprojë nëpërmjet filialeve të saj apo shoqërive të kontrolluara prej saj.

E gjithë kjo, në respektim të legjisacionit që rregullon çështjet specifike të listuara më sipër, ndalimet, kufizimet dhe kërkesat ligjore dhe, prandaj, i nënshtronen lejeve, autorizimeve dhe regjistrimeve që mund të janë të nevojshme dhe në përputhje me të gjitha kushtet e tjera.

Shoqëria mundet, së fundi, në mënyrë instrumentale, të kryejë cdo veprim tregtar, në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

KAPITALI I SHOQËRISË

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqindmijë) Leke.

6.2 Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 3 (tre) kuota, kapital i cili do te paguhet ne para nga ortaket.

6.3 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet nga Ortaket e Shoqërisë:

- Apostol Dhimiter PAPA , i datelindjes 19.04.1972, lindur në Mazhan, Përmet, banues në Tiranë, i identifikuar prej meje nëpërmjet Leternjoftimit ID me nr. Personal H20419061F, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i cili zoteron 1 (nje) kuote te kapitalit ne vlere nominale 30 000 leke qe perfaqeson 30% (tridhjete)te kapitalit.

- Gramoz Safet TODORI, i datëlindjes më 27.05.1989, lindur në Kollovoz, Kukës, dhe banues në Tiranë, identifikuar nepermijet Leternjoftimit ID me nr. Personal I90527045F, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili zoteron 1(nje) kuote te kapitalit ne vlere nominale 40 000 leke, qe perfaqeson 40% (dyzete)te kapitalit.

-Ylvi Sami DURMISHI, i datelindjes 20.12.1990, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, Identifikuar nepermijet Leternjoftimit ID me nr. Personal J01220066A, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i cili zoteron 1 kuote ne vlere nominale 30 000 leke, qe perfaqeson 30% (tridhjete) te kapitalit.

6.4 Kuotat janë të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe këtë Statut.

6.5 Përgjegjësia e ortakut për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me Statututin dhe jane të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga Statuti, nga ligji në fuqi "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përparrë datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

Asambleja mblidhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit finanziar, për miratimin e raportit të administratorëve, pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore.

Vendimet e zakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë, që përfaqësojnë të paktën 40% të të gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, ndarjen e fitimeve, prishjen e Shoqërisë, konsiderohen vendime të Asamblese.

Vendimet si me siper merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë, që përfaqësojnë të paktën 80% të të gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.

Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme vendos për:

përcaktimin e politikave tregtare

ndryshimin e Statutit

emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre

emërimin dhe shkarkimin e likuidatori/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre

mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë

miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë

miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë

pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre

përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve

shpërndarjen e fitimeve

riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë

miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë

çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut

Shoqëria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person fizik, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori/ët emërohet/n për një periudhë 2 (dy) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas ligjit.

Administrator i parë i Shoqërisë caktohet Z. Gramoz Safet TODORI, i datëlindjes më 27.05.1989, lindur në Kollovoz, Kukës, dhe banues në Tiranë, identifikuar nepermjet Leternjoftimit ID me nr. Personal I90527045F, madhor me zotesi te pote juridike per te vepruar.

Llogaria bankare te celet nga Administratori i Shoqërisë Z. Gramoz Safet TODORI.

Administrator i parë i Shoqërisë Z. Gramoz Safet TODORI, ka te drejte realizoje derdhje ne llogarite e Shoqerise, te realizoje transferta, terheqje apo cdo lloj veprimi tjeter ne keto llogari. Ne rast transfertash, terheqje apo veprime te tjera ne llogarine e shoqerise qe tejkalojne administrimin e zakonshem shoqerise administratori duhet te mari miratimin e ortakeve te shoqerise.

Vetem personi i pajisur me Autorizim (Prokure E Posacme) nga Administratori i Shoqërisë Z. Gramoz Safet TODORI, ka te drejte te realizoje transferta, terheqje apo cdo lloj veprimi tjeter ne llogarite e Shoqerise.

Nënshkruar, sot më datë 02.03.2023

Akti Themelimin u perpilua ne 4 kopje me vlerë te njejte ligjore, u lexua ne prani te Paleve te intersuara me ze te larte, te qarte, kuptohet, mbasi u gjet e perpiluar ne perputhje me vullnetin e lire, te pote dhe me Ligjin, u nenshkrua rregullisht, me pas une Noteri Publik vertetoj ato sipas kompetencave qe me jep Ligji Nr.110 date 20.12.2018 "Per Noterine".

ORTAKET E SHOQERISE

Apostol Dhimiter PAPA
Apostol Dhimiter PAPA
Gramoz Safet TODORI
Gramoz Safet TODORI
Ylli Sami DURMISHI
Ylli Sami DURMISHI
Ergys Hoxha